

**20101553266**

**MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**

Në përputhje me nenin 18-a paragrafi 2 të ligjit “Për armët” (“Fletorja Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 7/05, 47/06, 42/07, 86/08 dhe 72/10), Ministri i Punëve të Brendshme miratoi

**RREGULLOREN PËR NDRYSHIME NË RREGULLOREN PËR PËRBËRJEN E KOMISIONEVE TË MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME PËR QITJET EKSPERIMENTALE, MËNYRËN E REALIZIMIT TË QITJEVE EKSPERIMENTALE DHE RUAJTJEN E FISHEKËVE NGA ARMËT E PËRDORURA PËR QITJET EKSPERIMENTALE**

Neni 1

Në Rregulloren që ndryshon Rregulloren për përbërjen e komisioneve të Ministrisë së Punëve të Brendshme për qitjet eksperimentale, mënyrën e realizimit të qitjeve eksperimentale dhe ruajtjen e fishekëve nga armët e përdorura për qitjet eksperimentale (“Fletorja Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 94/09) neni 4 ndryshohet me këtë përmbajtje:

“Qitjet eksperimentale realizohen në objekte (poligone) që:

- përdoren nga Minsitria e Punëve të Brendshme për nevojat e saj;
- përdoren nga Ministria e Mbrojtjes dhe Ushtria e Republikës së Maqedonisë për nevojat e tyre;
- plotësojnë kushtet e parashikuara në Rregulloret për kërkesat minimale teknike dhe të sigurisë që duhet të plotësojnë objektet në poligonet civile të qitjes.”

Neni 2

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e tetë pas botimit në “Fletoren Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.

Numër 141-91057/1  
18 nëntor 2010  
Shkup

Ministre  
e Punëve të Brendshme,  
**MA Gordana Jankuloska**, nënshkrimi